



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R.nr. 231/2024

R.nr. 234/2024

R.nr. 244/2024

lidhur me

bazën ligjore për përcaktimin e kriterit të moshës për aplikim në konkurs në Doganën e Kosovës

Për:

Z. Agron Llughaliu, Drejtor i përgjithshëm
Dogana e Kosovës

Kopje:

Z. Hekuran Murati, Ministër
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 6 maj 2025

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky Raport ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Doganës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me caktimin e kriterit të moshës për pozitat specifike në Doganën e Kosovës dhe nëse këto kriterie bazohen në Kodin nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave.

KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

1. Avokati i Popullit, sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, par. 1);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 2);*
- *të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave (neni 18, par. 1, nënpar. 4);*
- *të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, par. 1, nënpar. 5);*
- *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, par. 1, nënpar. 6);*
- *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës (neni 18, par. 1, nënpar. 7);*
- *t’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv (neni 18, par. 1, nënpar. 9).”*

2. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i përmbushë këto përgjegjësi ligjore.

RRETHANAT E RASTIT

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, pranoi tri ankesa të ndara kundër Doganës së Kosovës, lidhur me kriteret e konkursit të shpallur më 7 mars 2024, për pozitën *oficer doganor*. Ankesat që pranuan janë si në vijim:

- Ankesa e [REDAKTUAR], e pranuar më 12 mars 2024, e regjistruar me numër regjistri R/244/2024;

- Ankesa [REDACTED], e pranuar më 14 mars 2024, e regjistruar me numër regjistri R/231/2024;
 - Ankesa [REDACTED], e pranuar më 14 mars 2024, e regjistruar me numër regjistri R/234.
4. Sipas informatave që pranuan nga ankuesit, konkursi i shpallur nga Dogana e Kosovës përmban kriteret diskriminuese mbi bazën e moshës, për shkak se kërkohet që mosha e kandidatëve të jetë prej moshës 18 deri në 30 vjeçare. Më tej, sipas ankesave, plotësimi i kushtit të moshës, përveçse është diskriminues, ai është edhe kundërtshënës, për shkak se një person 18 vjeç nuk është i diplomuar, i mungon përvoja e punës, e që në anën tjetër një nga kriteret e konkursit është edhe përvoja e punës. Për më tepër, aplikimi për pozitën *oficer doganor* është paraparë të bëhet online dhe se me rastin e aplikimit, kandidatëve që nuk e plotësojnë kriterin e moshës u është shfaqur njoftimi “*Vërejtje. Ju nuk mund të vazhdoni aplikimin. Nuk plotësohet kriteri i moshës*”, me ç’ rast atyre qysh në fillim u është pamundësuar aplikimi.
 5. Avokati i Popullit vëren se në konkursin e shpallur nga Dogana e Kosovës për pozitën *oficer doganor*, datë 7 mars 2024, te kriteret e aplikimit, pika 3, përcakton kriterin e moshës prej 18 deri në 30 vjeçare.
 6. Më 2 korrik 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar Drejtorisë së Doganës së Kosovës, me ç’ rast ka kërkuar informata lidhur me qëllimin legjitim të kriterit të moshës në konkursin e shpallur nga Dogana e Kosovës për pozitën *oficer doganor*.
 7. Më 23 korrik 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga Drejtoria e Doganës së Kosovës, në të cilën thuhet se kufizimi i së drejtës për aplikim në bazë të moshës, ashtu si edhe kriteret e tjera, përveçse është i arsyeshëm, është edhe i domosdoshëm dhe ligjërishit i bazuar. Sipas Doganës së Kosovës, kufizimi është paraparë me aktet e brendshme normative, konkretisht me Udhëzimin Administrativ Nr. 82/2024, datë 20.2.2024, për rregullimin e marrëdhënies së punës së oficerëve doganorë. Ky akt rrjedh nga neni 6 i Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave, legjislacion që ka qenë në fuqi në kohën kur është publikuar konkursi i rekrutimit.
 8. Dogana e Kosovës në përgjigjen e saj deklaroi se aktualisht mosha mesatare e stafit arrin moshën 50 vjeçare dhe numri i oficerëve që marrin leje mjekësore për shkak të kushteve kronike të shëndetit, të përkeqësuar nga mosha, është rritur ndjeshëm. Në përgjigje Dogana e Kosovës thekson se “*Dëshmitë empirike sugjerojnë se punonjësit më të moshuar kanë më shumë gjasa të vuajnë nga sëmundjet kronike, duke çuar në rritjen e mungesave edhe produktivitetit në punë.*” Studimet dhe praktika në Doganë kanë treguar se ekziston një lidhje midis moshës dhe prevalencës së sëmundjeve kronike, duke ndikuar në performancën dhe produktivitetin në punë. Pasojat e njëjta vlejnë edhe për impaktin negativ në aftësitë kognitive dhe mobilitetin fizik, gjë që vështirësojnë tej mase aftësinë për të operuar në rrethanat e organizatave të zbatimit të ligjit, siç është Dogana e Kosovës.” Sipas Doganës, kufij të ngjashëm të moshës aplikohen nga agjenci të tjera të sigurisë dhe zbatimit të ligjit, si Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Në përgjigje thuhet se një pjesë e vogël e stafit punojnë në zyrë, por që nuk ka një politikë që ndan dhe siguron natyrën e punës për një apo disa oficerë.

9. Për këtë arsye, sipas Doganës së Kosovës, kufiri i moshës për rekrutët e rinj konsiderohet një vendim strategjik i domosdoshëm, i cili synon të sigurojë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të operacioneve, duke adresuar pabarazitë demografike, mungesat për shkak të shëndetit dhe sfidat e transferimit të njohurive brenda organizatës. Dogana e Kosovës thekson se pas punësimit të grupit të ri të rekrutëve pritet një ndryshim pozitiv në moshën mesatare të stafit, gjë që mundëson shqyrtimin e mundësisë për zgjatjen e kufirit të moshës në rekrutimet e ardhshme.

ANALIZA LIGJORE DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

10. Duke marrë parasysh se konkursi për *oficer doganor* është shpallur më 7 prill 2024, kur në fuqi ka qenë Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, dispozitat e këtij kodi paraqesin sfondin ligjor për trajtimin e kësaj çështjeje.
11. Neni 6, paragrafi 4, i Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë përcakton: *“Personeli i Doganës me përjashtim të personelit ndihmës civil, punësohet nëpërmjet konkurrimit publik sipas kushteve të caktuara të procedurës të përzgjedhjes nga Drejtori gjeneral pas konsultimit me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.”*
12. Megjithëse në përgjigjen e datës 23 korrik 2024, Drejtoria e Doganës së Kosovës i referohet Udhëzimit Administrativ nr. 82/2024 për Kriteret për Aplikim për Oficer Doganor, i cili në nenin 2, paragrafi 2.3, përcakton kriterin e moshës së punësimit për oficer doganor nga mosha tetëmbëdhjetë deri në moshën tridhjetë vjeçare, ky udhëzim administrativ nuk mund të gjendet i publikuar as në Gazetën Zyrtare, as në faqen e MFPT-së dhe as në faqen e Doganës së Kosovës.
13. Përndryshe, i publikuar në faqen zyrtare të Doganës së Kosovës mund të gjendet një dokument i quajtur Udhëzues Lidhur me Procesin e Rekrutimit për Oficer Doganor, mars 2024.¹ Ky udhëzues, në mes të tjerash, përcakton kushtet minimale për aplikim për pozitën oficer doganor, ku një ndër kushtet (pika 3, faqe 4) ka të bëjë me përcaktimin e moshës tetëmbëdhjetë deri tridhjetë vjeçare.
14. Më 10 maj 2024, në Gazetën Zyrtare është publikuar Kodi nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas shpalljes së tij. Nenin 322 [Rekrutimi], paragrafi 5, përcakton: *“Rregullat procedurale, komisioni, llojet e testeve, kërkesat dhe kriteret shtesë si dhe çështjet tjera lidhur me rekrutimin sipas këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.”*
15. As Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (i shfuqizuar) dhe as Kodi nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave (në fuqi) nuk përcaktojnë kriteret për sa i përket moshës për punësim në Doganën e Kosovës.
16. Dokumenti i vetëm publik, i cili përcakton kriterin e moshës është *Udhëzuesi lidhur me Procesin e Rekrutimit për Oficer Doganor, mars 2024*, i cili nuk përmban ndonjë bazë ligjore e cila e lejon përcaktimin e kriterit të moshës.

¹<https://dogana.rks.gov.net/SharedFolder/DocumentFiles/Udh%C3%ABzues%20%20lidhur%20me%20procesin%20e%20rekrutimit.pdf>

17. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1, paragrafi 1, përcakton:
“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”
18. Komisioni i Venecias, si organ këshillues i Këshillit të Evropës për çështje kushtetuese, ofron udhëzime për mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut. Ai përcakton parime kyçe për sundimin e ligjit,² si: ligjshmëria, siguria juridike, ndalimi i arbitraritetit, qasja në drejtësi, respektimi i të drejtave të njeriut dhe barazia para ligjit.
19. Kufizimet e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut duhet të bëhet vetëm me ligj të miratuar nga Kuvendi. Kjo qasje siguron që çdo kufizim të jetë i bazuar në ligj, transparent dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes demokratike. Sipas nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.”* Gjithashtu, Komisioni i Venecias thekson se çdo kufizim i të drejtave duhet të jetë i parashikuar me ligj, të ketë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcional.
20. Avokati i Popullit rikujton se Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në nenin 6 të tij përcakton se: *“Pavarësisht nga nenet 3 dhe 4 të këtij Ligji, nuk konsiderohet diskriminim dallimi në trajtim i cili bazohet në dallimet e dhëna në bazat e nenit një (1) të këtij Ligji, mirëpo i cili si i tillë paraqet karakteristikën reale dhe përcaktuese me rastin e punësimit, qoftë për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, nëse ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.”*
21. Në sistemet demokratike, sikur edhe në Republikën e Kosovës, ndarja e pushteteve është faktor qenësor për sundimin e ligjit. Kjo ndarje siguron që pushtetet legjislative të kenë autoritetin për të miratuar ligje, ndërsa organet ekzekutive t’i zbatojnë këto ligje. Kjo strukturë parandalon përqendrimin e pushtetit dhe mbron të drejtat e individëve. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se në disa juridiksione, parlamentet mund t’u japin organeve ekzekutive disa pushtete ligjvënës, duke ua lejuar atyre të nxjerrin rregullore ose akte nënligjore brenda kornizës së krijuar nga legjislacioni kryesor.
22. Më tej, Avokati i Popullit rikujton se Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, në vetë qëllimin e tij thekson se i njëjti është në përputhshmëri me Direktivën e Këshillit 2000/78/EC, të datës 27 nëntorit 2000 që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion të Këshillit të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, Avokati i Popullit do i referohet një rasti i cili do shërbejë si interpretim të asaj se cilat janë parimet e vendosura të mos-diskriminimit në bazë të moshës sipas standardeve të BE-së.

² https://www.venice.coe.int/images/SITE%20IMAGES/Publications/Rule_of_Law_Check_List.pdf

23. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE), ka trajtuar çështjen e diskriminimit në moshë në rastin *Mario Vital Pérez v Ayuntamiento de Oviedo* (Akgjykim i 13 nëntorit 2024).
24. Z. Vital Pérez një shtetas i Spanjës aplikoi në forcat e policisë së Oviedos por u refuzua pasi ishte mbi 30 vjeç. Rezulton që disa komuna të Spanjës kishin vendosur kufij të moshës për rekrutimin e oficerëve të policisë. Rrjedhimisht aplikuesi paraqiti një padi në gjykatat e rregullta për të kundërshtuar këtë kufi në moshë. Gjykata vendase ia referoi çështjen GJDBE-së për të pyetur nëse kufiri i moshës mund të trajtohet ose si një kërkesë e vërtetë profesionale sipas nenit 4 paragrafi 1 të Direktivës 2000/78/EC ose të justifikuar objektivisht sipas nenit 6 paragrafi 1 të Direktivës 2000/78/EC.
25. Sipas Vendimit të GJDBE, e njëjta theksoi se është e kuptueshme që detyrat e oficerëve të policisë lokale përfshijnë ofrimin e ndihmës për qytetarët, mbrojtjen e personave dhe pronës, arrestimin dhe mbajtjen e kryesve të shkeljeve të ligjit, kryerjen e patrullave për parandalimin e krimit dhe kontrollin e trafikut. GJDBE theksoi se mund të theksohet se zotërimi i kapaciteteve të veçanta fizike mund të konsiderohet si një "kërkesë e vërtetë dhe përcaktuese profesionale" sipas kuptimit të nenit 4(1) të Direktivës 2000/78 për qëllime punësimi si oficer policisë lokale. GJDBE theksoi se në rastin e zjarrfikësve për shkak të natyrës së punës kërkohen kapacitete fizike "jashtëzakonisht të larta", dhe disa nga kapacitet që kërkohen për oficeret policor nuk janë të krahasueshme me zjarrfikësit. GJDBE rrjedhimisht, sa i përket kërkesave profesionale të moshës 30 vjeçare theksoi se janë jo-proporcionale.
26. Së dyti, sa i përket arsyetimit të dallimeve në trajtimin për shkak të moshës, GJDBE, theksoi se dallimet në trajtim për shkak të moshës nuk duhet të përbëjnë diskriminim nëse, brenda kontekstit të ligjit kombëtar, ato justifikohen objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga një qëllim legjitim, duke përfshirë politikën legjitime të punësimit, tregun e punës dhe aftësimin profesional, dhe nëse mjetet për arritjen e atij qëllimi janë të përshtatshme dhe të domosdoshme.
27. GJDBE-ja u shpreh se, megjithëse ligji nuk i përcaktonte shprehimisht qëllimin e tij, kufiri i moshës bazohet në kërkesat e trajnimit të postit në fjalë dhe nevojën për një periudhë të arsyeshme punësimi përpara daljes në pension ose transferimit në një aktivitet tjetër. GJDBE theksoi se politikat sociale dhe të punësimit, janë në diskrecion të shteteve anëtare por ato nuk duhet të rezultojnë në diskriminim në bazë të moshës. Në mungesë të provave dhe mungesë së qëllimit përcaktuar mirë të ligjit GJDBE, theksoi se mosha maksimale e rekrutimit prej 30 vjeç për oficerët e policisë vendore nuk mund të konsiderohet si e nevojshme për të siguruar që këta oficerë të kenë një periudhë të arsyeshme punësimi përpara daljes në pension për qëllimet e pikës (c) të nënparagrafit të dytë të nenit 6(1) të Direktivës 2000/78.
28. Avokati i Popullit vëren se Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë (i shfuqizuar) dhe Kodi nr. 08/L-247 Doganor dhe i Akcizave (në fuqi) nuk përcaktojnë kriteret për sa i përket moshës për punësim në Doganën e Kosovës.
29. Kriteret e tilla, sipas Doganës së Kosovës, thuhet se janë përcaktuar me Udhëzim Administrativ nr. 82/2024, i cili nuk mund të gjendet i publikuar. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit arriti ta siguronte nga Zyra Ligjore e Doganës një kopje të këtij udhëzimi administrativ, i datës 2 shkurt 2024, i nënshkruar nga drejtori i Doganës, me titull:

Udhëzimi Administrativ Nr. 82 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 37/2016 i ndryshuar dhe i plotësuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 69/2019 dhe Nr. 77/2022 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës së Oficerëve Doganor. Nga kopja e siguruar nuk mund të konkludohet nëse ky udhëzim është në fuqi, ngase vërehet se dokumenti përmban shenjen (watermark) se ky është një draft-dokument.

30. Avokati i Popullit konstaton se kriteri i konkursit të shpallur më 7 mars 2024, për pozitën *oficer doganor*, që ka të bëjë me përcaktimin e moshës, nuk ka bazë të qartë ligjore, se kriteri përcaktohet me një udhëzim administrativ të nënshkruar nga drejtori i Doganës dhe se ky udhëzim nuk gjendet i publikuar.
31. Avokati i Popullit e ka parasysh se mund të vendosen kufizime të të drejtave të njeriut kur ekziston ndonjë qëllim legjitim. Arsyetimet e ofruara nga Dogana e Kosovës jo vetëm që nuk paraqesin qëllim legjitim, por ato paraqesin diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave mbi 30 vjeç, diskriminim ky i bazuar në paragjykime të pa vërtetuara e argumentuara që kanë të bëjnë me aftësitë fizike dhe mendore të këtyre personave. Për më tepër, Dogana e Kosovës shprehet qartazi se me vendosjen e kriterëve të tilla synon që të arrijë një ndryshim pozitiv në uljen moshës mesatare të stafit, e që si arsyetim i tillë, nuk mund të pranohet nga Avokati i Popullit sepse siç u sqarua më lart, kur bëhet një trajtim ndryshe i njëjti mund të bëhet për shkaqe të aktiviteteve profesionale ose të vetë kontekstit në të cilin kryhen punët e caktuara profesionale, por me kusht që ajo dispozitë, kriter ose praktikë është e justifikuar nga një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar.
32. Avokati i Popullit vlerëson se krahasimi që Dogana e Kosovës e bën me Policinë e Kosovës dhe me FSK-në është juridikisht i paqëndrueshëm, ngase këto dy institucione, nëpërmjet akteve që rregullojnë fushëveprimin e tyre, të punësuarit i klasifikojnë në kategori për të cilët kërkohet kufi më i ulët i moshës. Në anën tjetër nga vetë përgjigjja e Doganës së Kosovës mësohet se Dogana nuk ka një politikë që ndan dhe siguron natyrën e punës për një apo disa oficerë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit vlerëson se sikur të ekzistonte kjo lloj ndarjeje, e vendosur me aktet normative që kanë një bazë ligjore dhe që këto akte të jenë publike dhe të qasshme, dhe të njëjtat të kenë qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale, atëherë vendosja e kriterëve të moshës për grupe të caktuara të të punësuarve në Doganë do të mund të arsyetohej.

PËRFUNDIM

33. Duke u bazuar në analizën e mësipërme, Avokati i Popullit ka evidentuar disa shkelje në procesin e rekrutimit për pozitën *oficer doganor* e që i referohen kryesisht mungesës së bazës ligjore për aplikimin e kriterit të moshës dhe përjashtimin e padrejtë të kandidatëve mbi moshën 30 vjeçare. Shkeljet të cilat Avokati i Popullit i ka konstatuar janë: mungesa e bazës ligjore për vendosjen e kriterit të moshës; mungesa e qëllimit legjitim për një kufizim të tillë; përdorimi i një akti që nuk është i qasshëm dhe që nuk është publik. Së këndejmi, Avokati i Popullit vlerëson se Dogana e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit dhe mund të konsiderohet qasje diskriminuese që për bazë ka moshën e kandidatëve për këtë pozitë. Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Doganës së Kosovës:

1. Ta ndryshojë Udhëzimin Administrativ nr. 82/2024 për Kriteret për Aplikim për Oficer Doganor, duke e fshirë nenin 2, paragrafi 2.3, që përcakton kriterin e moshës së punësimit për oficer doganor që duhet të jetë nga mosha tetëmbëdhjetë deri në moshën tridhjetë vjeçare.
2. Ta publikojë Udhëzimin Administrativ nr. 82/2024 për Kriteret për Aplikim për Oficer Doganor, të ndryshuar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit